

## Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, në Universitetin Teknik të Rigës në Letoni, në kuadër të programit Erasmus +.

### Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë semestrin e dytë të vitit akademik 2023-2024 në Universitetin Teknik të Rigës në Letoni.

### Kush mund të aplikojë:

Mund të aplikojnë studentët e UMT të cilët gjatë vitit akademik 2023 -2024 do të jenë në vitin e *dytë dhe të tretë*, të ciklit *bachelor* si edhe studentët e vitit të *parë dhe të dytë master*, në fushat/fakultetet:

- *Fakulteti i Ekonomisë (bachelor dhe master);*
- *Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT (bachelor dhe master);*
- *Dega Arkitekturë (aplikojnë vetëm studentët që për vitin 2023-2024 do të kenë përfunduar semestrin e 4, pra do të jenë në vitin e tretë).*

Lëndët të cilat zhvillohen në anglisht në universitetin pritës në semestrin e dytë i gjeni duke klikuar në linkun: <https://international.rtu.lv/course-list-for-exchange-studies/>

Vini re: Vetëm studentët që studiojnë në fushën e Biznesit/Menaxhimit/Ekonomisë mund të zgjedhin kurse nga Fakulteti i Inxhinierisë Ekonomike në Riga; Studentët në ciklin bachelor nuk mund të zgjedhin lëndë në nivelin master.

### Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia do të jetë në gjuhën angleze.

### Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (800 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

## Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Vërtetim dhe Listë notash e ciklit aktual të studimit;
- Kopje e pasaportës;
- Fotokopje e Certifikatës/dëshmi e gjuhës angleze ose dokument që vërteton njohuritë në këtë gjuhë. Niveli i kërkuar B2; Nqs mungon certifikata e njohur ndërkombëtarisht atëherë pajisuni me një certifikatë nga lektori i gjuhës angleze në UMT;
- Studentët e Arkitekturës duhet të dorëzojnë dhe portofolin me punimet e tyre;
- Dokumenti Learning Agreement\*

*\* Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Teknik të Rigës në Letoni lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë të vitit akademik 2023/2024 në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të jepni provim lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Metropolitan Tirana.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti dhe më pas në seksionin “sending university” firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit në UMT.*

Afati për aplikim: **10 Tetor, 2023**

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentet të skanuara me e-mail në adresën [iro-projects@umt.edu.al](mailto:iro-projects@umt.edu.al) ose dorazi në Drejtorinë e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin Metropolitan Tirana.

***UMT ju uron shumë suksese në aplikimin tuaj!***